

**RELACION SHPJEGUES PËR PROJEKTVENDIMIN:
“MBI
MIRATIMIN E RREGULLAVE TË PËRGJITHSHME PËR
PROCEDURAT E DHËNIES TË SË DREJTËS SË KALIMIT PËR
NDËRTIMIN E RRJETEVE TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE
ME SHPEJTËSI TË LARTË”**

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektakti vjen si propozim i Ministrisë për Infrastruktura dhe Energji, në zbatim të pikës 4, të nenit 26, të Ligjit Nr. 120/2016 “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë dhe sigurimin e të drejtës së kalimit” dhe synon plotësimin e kuadrit nënligjor që del i nevojshëm me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 120/2016. Ky projektakt ka për qëllim të miratojë rregulla të përgjithshme për procedurat e dhënies të së drejtës së kalimit me qëllim ndërtimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektakti është parashikuar në programin analitik të akteve për vitin 2017, dhe vjen si nevojë e plotësimit të kuadrit nënligjor në zbatim të ligjit Nr. 120/2016 “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë dhe sigurimin e të drejtës së kalimit”.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Ligji Nr. 120/2016 “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë dhe sigurimin e të drejtës së kalimit”, në pikën 4, të nenit 26 ka parashikuar miratimin e rregullave të përgjithshme për procedurat e dhënies të së drejtës së kalimit për ndërtimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë. Miratimi i këtyre rregullave të përgjithshme do të adresojë një problematikë disa vjeçare të mungesës së procedurave të mirëfillta të dhënies të së drejtës së kalimit sipërmarrësve për të ndërtuar rrjetin e komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë si dhe moszbatimit të parimit të objektivitetit, transparencës dhe jodiskriminimit në trajtimin e këtyre kërkesave.

Relacion shpjegues për Projektvendimin “Mbi miratimin e rregullave të përgjithshme për procedurat e dhënies të së drejtës së kalimit, për ndërtimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë”

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektakti është hartuar në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës si dhe të pikës 4 të nenit 26 të ligjit Nr. 120/2016 “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë dhe sigurimin e të drejtës së kalimit”.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Projekt akti nuk transponon ndonjë akt të veçantë të acquis së BE-së.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projekt akti është i organizuar në 13 nene dhe dy Aneke si më poshtë:

Në **nenet 1-5** parashikohet se çfarë përfshin e drejta e kalimit për ndërtimin e rrjetit të komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë, se kjo e drejtë duhet të ofrohet nën kushte të barabarta, objektive, transparente dhe jodiskriminuese për çdo sipërmarrës të komunikimeve elektronike. Gjithashtu parashikohen rastet kur kjo e drejtë kalimi nuk ofrohet të tilla si kur cenon sigurinë dhe integritetin e rrjetit dhe të pronës, sigurinë kombëtare dhe atë të shëndetit publik etj.

Në **nenin 6** parashikohet dokumentacioni dhe informacioni që duhet të depozitohet sipërmarrësi i rrjeteve të komunikimeve elektronike në momentin e aplikimit për leje të së drejtës së kalimit për të ndërtuar rrjetin e komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë.

Në **nenin 7** parashikohet rasti kur sipërmarrësi aplikon njëherazi si për lejen e ndërtimit dhe atë të së drejtës së kalimit.

Në **nenin 8** parashikohet se pas shqyrtimit të dokumentacionit përkatës për aplikimin për leje të së drejtës së kalimit, Autoriteti përgjegjës merr vendim për miratimin ose refuzimin e kësaj të drejte duke arsyetuar vendimin përkatës.

Në **nenin 9** parashikohet vendimi i autoritetit përgjegjës për miratimin dhe refuzimin e lejes të së drejtës së kalimit dhe se çfarë elementësh duhet të përmbajë vendimi përkatës.

Në **nenin 10** parashikohet e drejta sipërmarrësit për të ankimuar vendimin e Autoritetit përgjegjës për refuzimin e lejes të së drejtës së kalimit pranë gjykatës administrative kompetente.

Në **nenin 11** parashikohet se çfarë masash duhet të marrë sipërmarrësi i rrjeteve të komunikimeve elektronike pas miratimit të lejes të së drejtës së kalimit.

Në **nenin 12** parashikohet e drejta e sipërmarrësit të rrjeteve të komunikimeve elektronike për të modifikuar, rinovuar dhe revokuar lejen e së drejtës së kalimit.

Në **nenin 13** parashikohet se autoritetet përgjegjëse që japin lejen e së drejtës së kalimit duhet të miratojnë dhe publikojnë rregulla të detajuara për procedurat e dhënies të së drejtës së kalimit, të cilat duhet të jenë transparente, objektive dhe jodiskriminuese.

Në **Aneksin 1**, parashikohet Formulari TIP i aplikimit për leje të së drejtës së kalimit pranë institucioneve përgjegjëse, i cili përmban edhe dokumentacionin që duhet të paraqesë sipërmarrësi në momentin e aplikimit për leje të së drejtës së kalimit.

Në **Aneksin 2**, parashikohet Formatin TIP për lejen e së drejtës së kalimit, i cili përmban edhe afatin e dhënies të së drejtës së kalimit.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Institucionet që ngarkohen për zbatimin e këtij projektakti janë organet e qeverisjes qendrore dhe ato vendore.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektakti është hartuar nga një grup pune dhe është mbështetur në praktika e mira të vendeve tjera të rajonit.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projektakti nuk ka ndikim në të ardhurat dhe shpenzimet e buxhetit të shtetit.

MINISTRI

DAMIAN GJIKNURI